



VENDIMI MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 korrik 2022

Nr. i lëndës: 2019-02

Driton Hajdari dhe Teuta Bici-Hajdari

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) i mbledhur më 7 korrik 2022, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Snježana BOKULIĆ, ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit
Z. Alexander FASSIHI, anëtar

Asistuar nga:
Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Kjo ankesa është regjistruar më 18 tetor 2019.
2. Me letrën e datës 21 tetor 2019, Paneli informoi shefin e Misionit ("ShM") të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë ("Misioni") se ky rast ishte regjistruar.
3. Më 12 nëntor 2019, Paneli kërkoi nga ankuesit që të ofrojnë informata shtesë në lidhje me lirimimin e parë të ankuesit nga burgimi. Në bazë të këtij njoftimi, Paneli gjithashtu kërkoi nga ankuesit që të konfirmojnë nëse dëshirojnë të vazhdojnë ankesën e tyre. Më 19 nëntor, ankuesit konfirmuan se ankuesi i parë ishte liruar nga burgimi dhe konfirmuan synimin për të vazhduar me ankesën.
4. Më 22 janar 2020, Paneli i ka dërguar një deklaratë të kërkesave dhe pyetjeve shefit të Misionit ("ShM") të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë ("Mision-i") duke ftuar Misionin të dorëzojë përgjigjet e pyetjeve deri më datën 23 mars 2020.

5. Më 30 korrik 2021, ShM-ja ka dorëzuar përgjigjet dhe vërejtjet e tij për rastin.
6. Më 9 gusht 2021, letra e ShM-së iu dorëzua për informim ankuesve, të cilëve iu dha afat deri më 10 shtator 2021 për të bërë ndonjë parashtrësë tjetër në përgjigje të asaj letre.
7. Më 10 shtator 2021, ankuesit kanë dorëzuar përgjigjen.

II. PËRBËRJA E PANELIT

8. Pas dorëheqjes së njërit prej anëtarëve të tij të jashtëm, Paneli do të mbledhet për këtë çështje me vetëm dy anëtarë në përputhje me rregullën 14 (4) të rregullores së punës së Panelit.

III. FAKTET

9. Ankuesit janë z. Driton Hajdari dhe bashkëshortja e tij, znj. Teuta Bici-Hajdari, me vendbanim në Prishtinë. Ankesën e ka parashtruar znj. Bici-Hajdari, si përfaqësuese e autorizuar, në emër të bashkëshortit të saj, z. Driton Hajdari, si dhe në emër të saj.
10. Më 17 dhjetor 2012, z. Driton Hajdari është dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë (P. nr. 592/2011) për tentim vrasje të rëndë në bashkëkryerje dhe është dënuar me shtatë vjet burgim. Dy gjyqtarë të EULEX-it, nga të cilët një kryesues dhe një gjykatës vendor ishin pjesë e trupit gjykues në atë gjykimin penal.
11. Më 12 dhjetor 2013, dënimi i z. Hajdari ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit (PAKR nr. 102/2013) dhe ishte modifikuar për të llogaritur periudhën kohore që ai kishte kaluar në paraburgim. Dy gjyqtarë të EULEX-it, nga të cilët një kryesues dhe një gjyqtar vendor ishin pjesë e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit.
12. Më 3 shtator 2014, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar kërkesën e z. Hajdari për mbrojtjen e ligjshmërisë (Pml.Kzz. 98/2014). Trupi gjykues i Gjykatës Supreme ishte i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it, nga të cilët një kryetar dhe një gjykatës vendor. Në këtë mënyrë, dënimi dhe shpallja e dënimit e z. Hajdari mori formën e prerë.
13. Diku në vitin 2015, përderisa z. Hajdari ishte në burgim në Qendrën Korrektuese në Dubravë, ai u diagnostikua me sklerozë laterale amiotrofike (SLA). Që atëherë, ai ishte shtruar rregullisht për tretman në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë.
14. Pas kërkesës së z. Hajdari më 6 qershor 2017 drejtuar Gjykatës Themelore të Prishtinës për pezullimin e përkohshëm të ekzekutimit të dënimit me burg për shkaqe mjekësore, kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka kërkuar nga ekipi i ekspertëve mjekësorë të Shërbimi Klinik Spitalor dhe Universitar të Kosovës (ShKSUK) për të ofruar ekspertizë mjekësore. Më 28 korrik 2017, ekspertiza ka konfirmuar se z. Hajdari vuante nga SLA, një sëmundje kronike progresive për të cilën nuk ekziston shërim. Trajtimi konsiston në zbutjen e simptomave. Nga ekspertiza ndër të tjera u konkludua se *"Ambientet e burgut nuk kanë kushte adekuate për trajtimin e këtyre rasteve në fazat ku sëmundja ka avancuar shumë dhe në fazat e fundit të sëmundjes"*.
15. Më 3 gusht 2017, kryetari i Gjykatës Themelore të Prishtinës (Aktvendimi ED.nr.1160/2014) refuzoi kërkesën për pezullim të përkohshëm të ekzekutimit të dënimit.
16. Më 18 dhjetor 2017, ankuesit parashtruan kërkesë në Gjykatën Themelore të Prishtinës për lirim të parakohshëm të z. Hajdari. Kërkesa ishte refuzuar më 20 dhjetor 2017 (Aktgjykimi Kp.nr.1445/2017).
17. Më 4 janar 2018, Departamenti i Kujdesit Shëndetësor të Burgjeve i Ministrisë së Shëndetësisë i dërgoi një letër avokatit të z. Hajdari. Në këtë shkresë, ndër të tjera, thuhej

se Departamenti i Kujdesit Shëndetësor të Burgjeve i Ministrisë së Shëndetësisë nuk ka kushte materiale, profesionale apo farmaceutike për të mundësuar trajtimin e z. Hajdari.

18. Më 21 shkurt 2018, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës ka dorëzuar një mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në Gjykatën Themelore të Prishtinës lidhur me rastin e z. Hajdari. Avokati i Popullit ka konkluduar se,

“Mungesa e kujdesit të duhur mjekësor si dhe çfarëdo kujdesi tjetër të domosdoshëm së bashku me vuajtje fizike përbën trajtim poshtërues të paraparë me nenin 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe shkel të gjitha standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria. Prandaj, ndalimi i mëtutjeshëm i [Driton Hajdari] në kushtet dhe kujdesin e specifikuar në raportin e dorëzuar nga Departamenti i Kujdesit Shëndetësor të Burgjeve do të përbënte shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare të lartpërmendura të të drejtave të njeriut”.

19. Më pas, ankuesit paraqitën një kërkesë të re te kryetari i Gjykatës Themelore të Prishtinës për pezullim të përkohshëm të ekzekutimit të dënimit të z. Hajdari.
20. Më 14 mars 2018, kryetari i Gjykatës Themelore të Prishtinës miratoj kërkesën dhe ia pezulloi ekzekutimin e dënimit z. Hajdari për një periudhë prej pesë (5) muajsh, përkatësisht nga 14 mars 2018 deri më 14 gusht 2018.
21. Pas këtij aktvendimi, z. Hajdari ishte kthyer në shtëpi pranë familjes së tij për përkujdesje dhe trajtim.
22. Ndërmjet datës 15 gusht 2018 dhe 15 prill 2019, kryetari i Gjykatës Themelore të Prishtinës miratoi vazhdimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit të z. Hajdari në tri raste, zgjatja e fundit ishte deri më 15 korrik 2019.
23. Më 10 korrik 2019, kryetari i Gjykatës Themelore të Prishtinës (Aktvendimi ED.nr.155/2018) refuzoi vazhdimin shtesë të ekzekutimit të dënimit të z. Hajdari. Në aktvendim, kryetari në mes tjerash arsyetoi se sipas nenit 94 par. 6 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-94 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, *“Pezullimi i ekzekutimit të dënimit nuk mund të zgjasë përtej periudhës minimale të nevojshme për përfundimin e trajtimit mjekësor”.*
24. Më 20 korrik 2019 ose rreth kësaj date, pas vendimit të 10 korrikut 2019, z. Hajdari ishte arrestuar në shtëpinë e tij dhe ishte kthyer në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Me sa duket, menjëherë pas kësaj z. Hajdari ishte transferuar në QKUK për trajtim.
25. Më 26 korrik 2019, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka lëshuar një raport mjekësor lidhur me gjendjen e z. Hajdari. Në raportin e ShSKUK-së (nr. i referencës 330/19) ndër të tjera ishte konstatuar se,

“Ambienti i burgut nuk ka kushte për trajtimin e mëtutjeshëm të pacientit Driton Hajdari në këtë fazë të rëndimit të sëmundjes dhe gjendjes së përgjithshme të pacientit. Preferohet kujdesi familjar dhe në rast të përkeqësimit të frymëmarrjes dhe gjendjes së përgjithshme preferohet sërish shtrimi në spital, ku pacientit do t'i ofrohet asistencë respiratore me oksigjen si dhe asistencë për ushqyerjen me sondë nazogastrike”.

26. Më 2 gusht 2019, ankuesit dorëzuan një kërkesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për lirim me kusht të z. Hajdari për kohëzgjatjen e mbetur të dënimit të tij, të cilën Paneli për Lirim me Kusht i KGJK-së e refuzoi më 19 shtator 2019.
27. Më 11 tetor 2019, ankuesit parashtuan kërkesë për rishqyrtim të këtij aktvendimi.

28. Më 23 tetor 2019, Paneli për Lirim me Kusht i KGJK-së, duke vendosur lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim, miratoj kërkesën për lirim me kusht. Paneli për Lirim me Kusht urdhëroi që z. Hajdari të lirohet më 24 tetor 2019 dhe që të qëndrojë nën mbikëqyrjen e Shërbimit Sprovues të Kosovës gjatë gjithë pjesës së mbetur të dënimit, pra deri më 20 qershor 2021.
29. Më 15 nëntor 2021, në media u raportua se z. Hajdari kishte vdekur më 14 nëntor 2021.

IV. ANKESA

30. Ankuesit pohojnë se pjesëtarët e stafit të EULEX-it kanë monitoruar situatën e z. Hajdari në të gjitha fazat e burgimit dhe trajtimit të tij dhe kanë qenë të pranishëm në të gjitha procedurat gjyqësore pranë Gjykatës Themelore lidhur me kërkesat e tij për pezullim të përkohshëm të ekzekutimit të dënimit dhe kërkesat për lirim të parakohshëm, si dhe para Panelit për Lirim me Kusht të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me kërkesat e tij për lirim me kusht.
31. Ankuesit pretendojnë se për shkak të natyrës së profilit të lartë të rastit dhe interesit të veçantë të EULEX-it për të, autoritetet e Kosovës janë penguar dhe/ose iu ishte bërë presion që të përmbaheshin nga marrja e vendimeve të duhura dhe njerëzore në lidhje me trajtimin e z. Hajdari dhe lirimin nga burgimi. Ankuesit pohojnë se zyrtarët e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës i kanë informuar ata jo zyrtarisht që për shkak se z. Hajdari ishte ndjekur penalisht dhe dënuar nga EULEX-i, është EULEX-i ai që është përgjegjës për rastin e tij, dhe autoritetet e Kosovës nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim pa lejen e EULEX-it.
32. Sipas mendimit të ankuesve, kujdesi në shtëpinë e tyre ishte zgjidhja më e mirë për z. Hajdari, siç tregohet në raportin mjekësor të Shërbimit Klinik Spitalor dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) të datës 26 korrik 2019. Ankuesit pretendojnë se kujdesi në shtëpinë e tyre po pengohej nga EULEX-i për shkak të ndikimit të tij të tepërt ose të papërshtatshëm mbi autoritetet përkatëse të Kosovës në lidhje me këtë rast.
33. Ankuesit pretendojnë se z. Hajdari dhe gruaja e tij, znj. Bici-Hajdari, janë viktimat të shkeljes së të drejtave të tyre themelore në mbrojtjen nga trajtimi ose dënimi çnjerëzor ose poshtëruar si rezultat i vuajtjeve dhe vështirësive që u ishin shkaktuar. Ankuesit pretendojnë se EULEX-i është përgjegjës për situatën e tyre dhe për keqtrajtimin që kishte rezultuar.
34. Ankuesit pretendojnë se ka pasur shkelje të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar (KKT) nga ana e EULEX-it, pa specifikuar ndonjë dispozitë të veçantë.

V. PARASHTRIMET E PALËVE LIDHUR TË PRANUESHMËRISË

Shefi i Misionit ("ShM")

35. Në parashtresën e tij, ShM-ja ka theksuar se EULEX-i u informua për faktin se z. Driton Hajdari kishte probleme shëndetësore në qershor të vitit 2016, kur në përputhje me mandatin e tij për të mbështetur Shërbimin Korrektues të Kosovës (ShKK) në trajtimin e të burgosurve të profilit të lartë, Njësia Korrektuese (NJK) e EULEX-it filloi monitorimin e përcjelljes së tij drejt institucioneve të kujdesit shëndetësor dhe kthimit prej tyre, jashtë objekteve të institucioneve korrektuese. Gjatë monitorimit të përcjelljes së z. Hajdari, monitoruesit e NJK-së vunë re se gjendja e tij shëndetësore kishte filluar të përkeqësohej. Ata nuk kanë pyetur autoritetet për hollësitë e gjendjes së tij shëndetësore, pasi ky informacion mbrohet përmes konfidencialitetit mjekësor dhe Misioni nuk është dhe asnjëherë nuk ka pasur mandat për me i monitoru dhe këshillu institucionet shëndetësore. Sa herë që z. Hajdari dhe familjarët e tij si vizitorë iu ishin afruar monitoruesve të NJK-së,

ata dëgjonin shqetësimet e tyre dhe i këshillonin që të përdornin mjetet juridike në dispozicion, siç ishin kërkimi i pezullimit të përkohshëm të ekzekutimit të dënimit, kërkesa për lirim me kusht dhe parashtrimi i ankesës tek Avokati i Popullit i Kosovës. Monitoruesit e NjK-së gjithashtu kishin shpjeguar se çdo vendim sa i përket mjeteve të tilla ishte vetëm në kompetencën e autoriteteve përkatëse gjyqësore dhe shëndetësore.

36. ShM-ja ka theksuar se pas datës 15 qershor 2018, EULEX-i nuk ka pasur ndonjë rol apo përgjegjësi ekzekutive në lidhje me z. Hajdari. Megjithatë, EULEX-i ka vazhduar të bënte çdo gjë që mundi brenda kornizës së mandatit të vet 'joekzekutiv' të përshkruar më poshtë, për të promovuar realizimin e të drejtave të veta themelore. Që nga qershori i vitit 2018, EULEX-i Kosovë ka mandat që të monitoroj rastet dhe gjykimet e përzgjedhura në sistemin e drejtësisë së Kosovës (detyrë që zbatohet nga Njësia për Monitorimin e Lëndëve (NjML) në kuadër të Shtyllës së Monitorimit) dhe po ashtu ka mandat që të mbështet menaxhmentin e lartë të ShKK-së në aspektin e udhëheqjes dhe parimeve të menaxhimit duke monitoruar, mentoruar dhe këshilluar, përfshirë një prani të vazhdueshme të EULEX-it në burgje dhe qendra të paraburgimit.
37. ShM-ja përsërit se në monitorimin e procedurave të mësipërme, NJMK-ja vetëm i ka vëzhguar seancat. Staf i NjML-së së EULEX-it sipas mandatit dhe në përputhje me parimet e monitorimit (paanshmëri, neutralitet, mosndërhyrje) nuk lejohet të ndërmer asnjë veprim, apo të bëjnë ndonjë ndërhyrje apo deklaratë në ndonjë procedurë dhe as të ndikojnë në ndonjë vendim gjyqësor.
38. Në bazë të asaj që u përmend më sipër, Misioni konsideron se në lidhje me pretendimet e ngritura nga ankuesit rreth veprimeve dhe aktiviteteve të kryera nën mandatin e monitorimit dhe këshillimit të EULEX-it nga viti 2014 deri në vitin 2019, kur u lirua Driton Hajdari, akuzat e ankuesve janë të papranueshme, pasi nuk kanë asnjë ndërlidhje me mandatin ekzekutiv të EULEX-it. Veprimet e mësipërme ishin kryer në funksion të mandatit monitorues dhe këshillues të Misionit dhe në përputhje të plotë me parimin e mosndërhyrjes.

VI. VLERËSIMI I PANELIT

39. Pas dorëzimit të ankesës dhe para se Paneli të lëshonte vendimin, njëri nga ankuesit, z. Driton Hajdari, kishte vdekur. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe faktin se statusi i ankuesit të dytë është i pandryshuar, Paneli ka vazhduar të shqyrtojë pranueshmërinë e ankesës.
40. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohet në Konceptin e llogaridhënies së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) dhe Konventa kundër Torturës (KKT), të cilat përcaktojnë standardet minimale ndaj mbrojtjes së të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
41. Megjithatë, para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do të vazhdojë me ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29 të rregullores së tij të punës. Një kriter është se ankesa duhet të bie në kuadër të juridiksionit të Panelit.
42. Sipas rregullës 25, paragrafit 1, të rregullores së punës, Paneli mund t'i shqyrtojë ankesat në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Duke marrë parasysh konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it Kosovë, Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore që janë në gjykatat e Kosovës.

43. Paneli thekson se tema e ankesës është ndërhyrja e pretenduar e Misionit në vendimmarrjen e autoriteteve vendore gjatë ushtrimit të mandatit të tij monitorues.
44. Është mendimi i Panelit që nëse Misioni gjatë aktiviteteve të tij monitoruese ndërhyr në aktivitetet dhe kompetencat e autoriteteve vendore në një mënyrë që mund të interpretohet se Misioni vepron në një mënyrë ekzekutive, këto veprime (ndërhyrje) mund të bien brenda juridiksionit të Panelit, pasi Misioni atëherë mund të shihet se vepron në një mënyrë ekuivalente me ushtrimin e autoritetit ekzekutiv.
45. Megjithatë, ankuesit nuk kanë ofruar dëshmi se ndërhyrja e supozuar ka ndodhur.
46. Vetëm monitorimi përmes pranisë së tyre në objektet e SHKK-së dhe në procedura është qartazi jashtë mandatit ekzekutiv të Misionit. Monitorimi i një rasti mund të çojë në rregullimin e sjelljes së autoriteteve vendore duke siguruar, në një masë më të madhe sesa që përndryshe do ta bënin, që ata t'i përmbahen legjislacionit përkatës dhe standardeve ndërkombëtare. Ky është pjesërisht qëllimi i monitorimit. Kur autoritetet vendore nuk respektojnë legjislacionin përkatës dhe standardet ndërkombëtare, faji nuk mund t'iu vihet monitoruesve, roli i të cilëve në radhë të parë është të identifikojnë mangësitë e tilla. Kjo ende vlen kur përfaqësuesit e autoriteteve vendore, siç pohohet në këtë rast, mund të pretendojnë në mënyrë të pasaktë, se autoriteti i takon Misionit. Një pretendim i tillë, në vetvete, nuk mund të çojë në krijimin e një mandati ekzekutiv dhe bartjen e autoritetit tek Misioni.
47. Paneli dëshiron të ngrit shqetësimin në lidhje me trajtimin e gjendjes shëndetësore të z. Hajdarit nga autoritetet vendore. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se, sipas mendimit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, burgimi i mëtejshëm i Driton Hajdarit në kushtet dhe kujdesin siç ishin specifikuar në raportin e dorëzuar nga Departamenti i Kujdesit Shëndetësor të Burgjeve do të përbënte shkelje të nenit 3 të KEDNj-së dhe instrumenteve të tjera të lartpërmendura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Është e domosdoshme që këto shqetësime të trajtohen nga autoritetet vendore.
48. Në bazë të asaj që u përmend më sipër, rrjedh se kjo ankesë bie jashtë kuadrit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe rrjedhimisht jashtë kompetencës së Panelit, siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së tij të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se ankesa nuk hyn në kuadër të fushëveprimit të juridiksionit të PShDNj-së, sipas kuptimit të rregullës 29, l (d) të rregullores së tij të Punës.

SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

Snježana BOKULIĆ
Ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit

Alexander FASSIHI
Anëtar

